

Before electoral campaign as a political marketing news on Kosovo public television

Gjylie Rexha*

The news program of Radio television of Kosova becomes the platform to promote the electoral projects of political parties, even before the announcement of elections and the official beginning of electoral campaigns.

During the pre-campaign period, public broadcaster (RTK) uses legal gap to expand the presentation of the political leadership activities in the news program, despite the fact that this violates professional standards and responsibilities of public broadcasters to the audience.

Political communicators use the structure of the RTK news program, set up on the model of the pseudo-event, to promote electoral programs, in central parts of the news program of public television, which have to be dedicated to matters of public interest. With this approach, the editorial policy undermines RTK substantive quality of news and its "alliance" with the audience, because it does not provide the information which offers knowledge about political reality.

Key words: *RTK news, pre-campaign, Kosovo leadership, pseudo-event, public broadcast.*

*GjylieRexha, PhD Candidate, Prishtina. Email: gjylie@yahoo.com

Parafushata elektorale si marketing politik në lajmet e televizionit publik të Kosovës

Abstrakt

Lajmet e Radiotelevizionit të Kosovës shndërrohen në platformë të promovimit të projekteve zgjedhore, edhe para shpalljes së zgjedhjeve dhe fillimit zyrtar të fushatave elektorale. Në periudhat e parafushatave, RTK-ja shfrytëzon zbrazëtirën ligjore, për të zgjeruar hapësirën e prezantimit të aktiviteteve të lidërshiptit politik në lajme, pavarësisht se me këtë shkel standardet profesionale dhe përgjegjësitë e transmetuesit publik ndaj audiencës. Promovimi i aktiviteteve zgjedhore bëhet duke zënë hapësirën qendrore të lajmeve, të paraparë për raportimin mbi çështjet me interes shoqëror.

Komunikuesit politikë shfrytëzojnë strukturën e lajmeve të RTK-së, të ngritur mbi modelin e pseudo ngjarjes, për të promovuar programet zgjedhore. Lajmet e RTK-së i shërbejnë politikës si kanal për të përcjellë tek audiencia aktivitetet zgjedhore të paredaktuara dhe të patrajtuara në përputhje me standardet e mediumit publik. Me këtë qasje, politika editoriale e RTK-së e dëmton cilësinë përmbajtjesore të lajmeve dhe raportin e saj me audiencën, të cilës nuk i ofron informacion në formë dijeje për realitetin politik.

Fjalë kyç: *Lajmet e RTK-së, parafushata, lidërshipti i Kosovës, pseudo ngjarje, mediumi publik.*

Hyrje

Roli vendimmarrës i institucioneve shtetërore dhe forcave kryesore politike mbi çështjet e zhvillimit strategjik të Radiotelevizionit të Kosovës, i ka shndërruar ato në faktorë me ndikim edhe mbi politikën editoriale. Ndikimi është i përqendruar mbi përmbajtjen programore që lidhet me

funksionin primar për informimin e qytetarëve mbi realitetin, në të cilin protagonistët kryesorë janë faktorët vendimmarrës për RTK-në. Në sistemin shoqëror të Kosovës, në të cilin zhvillimet politike paraqesin sektorin kryesor në hierarkinë e lajmeve, RTK-ja zbaton politikë editoriale që i jep përparësi mbulimit të aktiviteteve të faktorëve politikë, por duke favorizuar disa prej tyre, në cilësinë e përfaqësimit në përmbajtjen e lajmeve. Siç e përshkruan Prof. Dr. Rrahman Paçarizi:

“Në kuptimin sasior, RTK-ja është shumë e balancuar në përfaqësimin e subjekteve politike, mirëpo edhe te RTK-ja edhe te mediat tjera, hilja është pastaj cilësore, në kuptimin e përballjes së aktorëve me sfonde dhe lidhje të ndryshme politike”.¹

Në mediat publike, në të cilat politika editoriale e ka të instaluar si praktikë pune raportimin protokollar, standardi kryesor profesional i paanshmërisë cenohet nga përmbajtja favorizuese ndaj subjekteve kryesore, që paraqiten si pjesë e pushtetit politik. Hapësira e lajmeve ndahet ndërmjet liderëve kryesorë, në pushtet dhe në opozitë, por ata të pushtetit zënë hapësirën kryesore duke u paraqitur në të dy kapacitetet e tyre: si udhëheqës shtetërorë dhe si liderë partiakë. Kjo dukuri dëmton cilësinë e lajmeve të RTK-së, sidomos në periudhat e parafushatave, kur hapësira publike transmetuese shndërrohet në kanal kryesor të komunikimit ndërmjet lidërshiptit qeveritar e politik dhe elektoratit, në kundërshtim me funksionet dhe përgjegjësitë e RTK-së për informim gjithëpërfshirës.

Mungesa e bazës ligjore dhe rregullave për mbulimin mediatic të periudhave të tilla, i mundëson politikës editoriale të mediumit publik që të zgjerojë hapësirën për marketing politik të lidërshiptit partiak brenda lajmeve, përmes përqendrimit të

¹ Intervistë me Prof. Dr. Rrahman Paçarizi, profesor i gjuhësisë dhe gazetarisë, kryetar i bordit të RTK-së në vitet 2009-2014. Intervistë e inçizuar në tetor 2016.

tyre vetëm në mbulimin si projekte elektorale dhe shmangies nga mbulimi i tyre sipas standardeve profesionale të RTK-së.

Metodologjia

Për përgatitjen e këtij punimi janë përdorur këto metoda: analiza e përmbajtjes dhe intervistat e strukturuar. Analiza cilësore dhe sasiore e përfaqësimit dhe mënyrës së mbulimit të projekteve politike në lajmet e RTK-së në periudhën e parafushatës, është ngritur mbi monitorimin e edicioneve qendrore të Televizionit të Kosovës në periudhën prill - maj 2014, gjithsejtë 60 edicione. Në funksion të analizës krahasuese me periudhat tjera të përfaqësimit politik, monitorimi është shtrirë edhe në periudhën e fushatës zyrtare për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014.

Intervistat e strukturuar me ekspertë të çështjeve të mediave dhe politikës, udhëheqës të RTK-së, deputetë të pushtetit dhe të opozitës si dhe ato me gazetarë e redaktorë të lajmeve të RTK-së, shërbejnë për analizën cilësore dhe nxjerrjen e rekomandimeve për mbulimin e periudhave të tilla problematike në mediumin publik të Kosovës.

Politika në lajmet e RTK-së

Proceset dhe zhvillimet politike zënë hapësirën kryesore në hierarkinë e sektorëve, në përmbajtjen e informacionit të mediumit publik në Kosovë. RTK-ja iu është përgjigjur fazave të tranzicionit nga protektorati në shpalljen e pavarësisë dhe fillimin e konsolidimit të subjektivitetit shtetëror të Kosovës, me politikë editoriale që i jep përparësi përcjelljes së mesazheve të politikës zyrtare tek audiencat e saj. Ajo ruan modelin e konsoliduar nga periudha e protektoratit të OKB-së, në

segmentet kryesore të politikës editoriale dhe të raportimit për zhvillimet politike, pavarësisht se ky model ngre çështjen nëse qëllimi i informacionit të saj është informimi i audiencës, apo propagandimi i objektivave të pushtetit politik.

Realiteti politik pas vitit 2008, karakterizohet nga ndasitë, mosmarrëveshjet, koalicionet e paqëndrueshme qeveritare, krizat politike e institucionale, ri-pozicionimet e forcave politike dhe përfshirja në sistemin politik e subjekteve të reja. Në këtë realitet, RTK-ja është gjetur përballë sprovës që buron nga përgjegjësia shoqërore e saj për të ofruar informacion të dobishëm për audiencën dhe përmbajtje “që siguron dije njohëse duke informuar për atë që ndodh, por edhe duke klasifikuar dhe strukturuar realitetin politik”². Sprova profesionale e ka shndërruar mediumin e vetëm në Kosovë me përgjegjësi shoqërore për ofrimin e informacionit me cilësi të lartë dhe llogaridhënie vetëm ndaj publikut, në institucionin më të kritikuar mediatik, si nga opinioni publik ashtu edhe nga vetë subjektet politike. Ajo kritikohet për politikën editoriale që kompenson me lajme të mira mungesën e aftësive të lidërshipt politik të Kosovës, ashtu siç e përshkruan Dr. Belul Beqaj:

“E keqja është heshtur, e mira është stërmadhuar. Transmetuesi publik nuk e ka reflektuar realitetin, por i ka reflektuar projeksionet e lidërshipt për realitetin, pavarësisht se ai kurrë nuk është përputhur me të vërtetën”³.

Në program kjo realizohet duke u përqendruar në raportimin për ngjarjet e paralajmëruara nga institucionet dhe forcat kryesore politike, me të cilat RTK-ja i paracakton vetes rolin e

² McNair Brian, *Hyrje në komunikimin politik*, UET Press, Tiranë 2009, fq 61

³ Intervistë me Dr. Belul Beqaj, ligjërues dhe ekspert i shkencave politike dhe mediae. Intervistë e realizuar përmes postës elektronike në gusht 2015.

mediumit që në mënyrë pasive bart mesazhet politike tek audienca. Duke u dhënë hapësirën kryesore në lajmet e saj, RTK-ja u ofron mundësinë politikanëve që të shfrytëzojnë mediumin publik për të propaganduar aktivitetet e tyre dhe në këtë mënyrë bëhet pjesëmarrës në “kufizimin e qasjes në mjedisin e vërtetë, para se të krijohet pseudo mjedisi i dëshirueshëm”.⁴

Hapësira që iu rezervohet aktiviteteve të liderëve të institucioneve dhe atyre politikë si dhe zyrtarëve tjerë të nivelit qendror dhe lokal, varet nga numri i aktiviteteve ditore që ata kanë dhe mund të arrijë deri në 25 nga 30 minuta të edicionit qendror të lajmeve, ose në ditët e fundit të parafushatës të përfshijë gjithë edicionin. Në këtë strukturë, pseudo ngjarjet janë burimi kryesor për lajmet dhe struktura e edicionit qendror ofrohet si mundësi për leadershipin institucional dhe partiak, që t’i përdorë lajmet për marketing politik, në kuadër të hapësirës transmetuese publike. Në lajmet e RTK-së, politikanët kryesorë dalin si komunikues të aftë për të shfrytëzuar hapësirën mediatike me synimin që të bindin qytetarët/votuesit për vërtetësinë e realitetit që prezantojnë, sepse RTK-ja nuk shkon përtej deklarimeve të tyre në kërkimin e së vërtetës për çështjet që ata ia servojnë publikut. Ashtu siç e përshkruan njëri nga gazetarët e politikës në RTK, prania e politikanëve është kriteri kryesor që përcakton rëndësinë e ngjarjes në praktikën e raportimit të përditshëm:

“Në ndarjen e detyrave në mbledhjet e mëngjesit, prioritet u jepet ngjarjeve ku janë të pranishëm Kryeministri, Ministri i Jashtëm, Kryetari i Kuvendit, etj. Mbulimi i ngjarjes nuk ka të

⁴ Lippman Walter, *Public opinion*, Transaction Publishers, New Brunswick USA 1991, fq 43

bëjë me rëndësinë e saj, por me praninë e figurave të forcave kryesore politike në atë ngjarje”.⁵

Modeli i raportimit të RTK-së nga ngjarjet e paralajmëruara për mediat është i ngritur mbi kronikat njëburimore që realizohen nga konferencat për shtyp, deklaratat e aktorëve politikë nga aktivitetet promovuese të projekteve ku marrin pjesë, njoftimet për aktivitetet e tyre përmes komunikatave për media, deklaratat pas takimeve protokollare, fjalimet dhe deklaratimet e tyre nëpër rrjete sociale. Me këtë mënyrë raportimi RTK-ja bëhet pjesë e mekanizmave që përdoren për krijimin e opinionit publik rreth çështjeve që liderët i paracaktajnë si të rëndësishme, por duke u larguar nga funksionet e saj të transmetuesit publik, që të raportojë “për të gjitha çështjet, përfshirë tensionet dhe mosmarrëveshjet politike, pasqyrimin real të gjendjes ekonomike dhe çështjeve tjera që shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë”.⁶

Udhëheqësit e RTK-së e pranojnë se politika e ka zënë hapësirën për zhvillimet tjera, mirëpo siç e arsyeton Drejtori i Televizionit të Kosovës Lorik Arifaj, kjo ndodh për shkak të gjendjes së përgjithshme në Kosovë:

“Fatkeqësisht, situata në të cilën është Kosova prej pasluftës e deri tash e ka imponuar në njëfarë forme pasqyrimin e temave politike, edhe para edhe pas shpalljes së pavarësisë. E dyta:

⁵ Nga intervistat e strukturuar me gazetarë dhe redaktorë të lajmeve në RTK, të realizuara në maj dhe gusht 2015.

⁶ Public Service Values – Editorial Principles and Guidelines, EBU Operating Eurovision and Euroradio, https://www.ebu.ch/files/live/sites/ebu/files/Publications/EBU-Public_Service_Values.pdf

gazetaria në Kosovë është e ndërtuar keq. Fatkeqësisht, një gazetar i mirë konsiderohet vetëm ai i cili e mbulon politikën”.⁷

Në këtë mënyrë, hapësira publike e përcaktuar për informacionin e dobishëm për qytetarët, në modelin e zbatuar nga RTK-ja, merret nga grupi i politikanëve të pushtetshëm, të cilët përmes ndikimit në zhvillimin e RTK-së sigurojnë praninë në përmbajtjen programore të saj. Lajmet e RTK-së i shërbejnë komunikimit të ndërsjellë ndërmjet protagonistëve kryesorë politikë, pasi që shndërrohen në lajme qëndrimet e tyre për njëritjetrin, por si të tilla nuk i shërbejnë informimit për realitetin politik në Kosovë.

Mbulimi i parafushatës në edicionet e lajmeve

Prania e liderëve të subjekteve kryesore politike në lajmet e RTK-së, rritet në periudha kur ofrohen zgjedhjet e rregullta, ose kur fillojnë paralajmërimet për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, si rrugëdalje nga krizat institucionale dhe politike. Parafushata si periudhë e veçantë dhe e papërcaktuar me legjislacionin në fuqi, paraqet kohën e shfrytëzuar nga subjektet politike për prezantimin e projekteve elektorale, para fillimit të fushatës zyrtare elektorale.

Si kërkues të votave, liderët i shndërrojnë në ngjarje mediatike takimet me elektoratin, ndërsa mediumi publik bëhet platforma kryesore duke përshtatur skemën e edicioneve të lajmeve me mbulimin e aktiviteteve elektorale, edhe para fillimit zyrtar të fushatave.⁸ Në periudhën e parafushatës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2014, RTK-ja ka liruar deri në 2/3-at

⁷ Intervistë me drejtorin e Televizionit të Kosovës Lorik Arifaj, e incizuar në tetor 2016.

⁸ Nga monitorimi i edicioneve qendrore të lajmeve, Lajme 19:30, në muajt prill dhe maj 2014.

e hapësirës së edicioneve të lajmeve, për takimet elektorale të liderëve të subjekteve kryesore politike shqiptare në Kosovë, edhe pse nuk ka pasur obligime ligjore për mbulimin e tyre. Në muajt prill dhe maj 2014, të dyja palët kanë shfrytëzuar zbrazëtirën që krijon legjislacioni në fuqi për RTK-në dhe ai për zgjedhjet,⁹ duke e transformuar hapësirën transmetuese publike në hapësirë të propagandimit të projekteve elektorale.

Në kërkimin e tyre për maksimizimin e numrit të votave, udhëheqësit e partive kryesore kanë përdorur pozitën shtetërore, për të tërhequr vëmendjen e mediumit publik, i cili në praktikën editoriale i trajton me prioritet aktivitetet e krerëve të institucioneve. Por, paralelisht me aktivitetet e kryeministrit, i cili ka përdorur pozitën shtetërore për prezantimin e projektit partiak elektorale, RTK-ja ka mbuluar edhe aktivitetet elektorale të pesë subjekteve tjera (LDK, Vetëvendosje, AAK, Nisma për Kosovën dhe AKR), duke u përqendruar në ngjarjet për mediat ku të pranishëm kanë qenë liderët e tyre. Duke mos lënë anash as subjektet opozitare, RTK-ja ka ndihmuar subjektet më të fuqishme politike që të zgjerojnë mbulimin mediatic promovues elektorale, pa iu nënshtruar standardeve profesionale për raportimin e paanshëm, të balancuar dhe objektiv që kërkohet me rregullat për zgjedhjet.

Orientimi i diskutimeve politike dhe publike në çështjen nëse RTK-ja u ka ofruar mbulim të barabartë të gjitha subjekteve dhe në anën tjetër, arsyetimet e udhëheqësve të lajmeve të RTK-së, tregojnë se asnjëra nga palët, megjithatë, nuk janë parimore në

⁹ Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, Nr. 04 / L - 46, Neni 18, pika 8, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7 / 27 prill 2012; Ligji Nr. 0/L-073, për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare 31/2008 dhe Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i publikuar në Gazetën Zyrtare më 16.11.2010

qasjen ndaj funksionit të informacionit si e mirë publike.¹⁰ Subjektet opozitare vetëm kanë këmbëngulur në kërkesat për hapësirë transmetimi për aktivitetet e tyre, ndërsa RTK-ja është shfajësuar duke arsyetuar hapësirën e dhënë me peshën e aktiviteteve dhe pasojat që krijon mungesa e përcaktimeve ligjore. Sipas drejtorit të Televizionit të Kosovës, Lorik Arifaj, i cili në kohën e parafushtës 2014 ka qenë ushtrues detyre i kryeredaktorit në televizion:

“Nuk kemi mundur të mos i përcjellim sepse kanë qenë zhvillimet kryesore dhe prej tyre është ditur se kush do të qeverisë vendin në të ardhmen. Jemi munduar të shohim përafrimet që kanë subjektet me subjekte të tjera dhe normalisht që e kanë diktuar përmbajtjen e edicioneve. Ajo që kemi bërë mirë është se i kemi balancuar, edhe pse nuk ka qenë fushatë dhe nuk kemi pasur obligim ligjor që t’i përcjellim”.

Në arsyetimet e udhëheqjes së RTK-së evidentohen probleme që pasqyrojnë mungesën e parimeve editoriale të mediumit publik, për situata të hirta, kur mediumi publik parimisht do të mund të identifikohet si bartës i profesionalizmit në sistemin mediatik të Kosovës. Mirëpo, duke mos qenë e tillë, ajo iu përgjigjet me vendime ad hoc situatave problematike dhe lejon që të vihet në lajthitje nga politikanët të cilët kanë interes për të, ashtu siç vlerësojnë studiuesit: vetëm derisa ajo ndikon, ose derisa perceptohet se ndikon në votat e tyre.¹¹

¹⁰ Shih: Deklarata nga konferenca për shtyp e LDK-së e datës 26 maj 2014, transmetuar në Lajmet 19:30 në RTK, marrë nga arkivi i lajmeve në kanalën youtube të RTK-së; Deklarata e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës Isa Mustafa, më 3 maj 2014, publikuar në faqen e tij zyrtare në Facebook <https://www.facebook.com/isamustafa.rks?fref=ts>

¹¹ Shih: Kuhn Raimond, *Broadcasting and politics in Western Europe*, Frank Cass and Company Limited, London 1985

Pa standarde profesionale të cilat do t'i garantonin pavarësinë editoriale, RTK-ja u ka ofruar mundësinë liderëve dhe partive më të fuqishme që të keqpërdorin sferën publike, duke përcaktuar agjendën e lajmeve të saj. Analiza e EU EOM (Misioni i Bashkimit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve) për periudhën e parafushatës, ka gjetur se të gjashtë partitë e mëdha shqiptare janë mbuluar në edicionin qendror të lajmeve në RTK dhe totali i informacionit për aktivitetet e partive, në ditët e fundit, ka arritur deri në 20 minuta (brenda edicionit 30 minutash v.j.), megjithëse më shumë mbulim i është dhënë PDK-së (EUEOM 2014). Në përqindje, sipas raportit, koha e mbulimit të aktiviteteve politike në Lajmet 19:30, në periudhën ndërmjet 8 dhe 27 majit (20 ditët e fundit të parafushatës) është: PDK 34%, LDK 21%, AAK 15%, Vetëvendosje 13%, AKR 9%, Nisma 6%.¹² Por, më me rëndësi se sa mungesa e balancimit në përqindjen e kohës për subjektet politike, në këto raste është përfaqësimi dhe trajtimi cilësor përmbajtjesor në lajme.

Anshmëria përmes favorizimit në raportim

RTK-ja ka kombinuar elemente të mbulimit të zakonshëm të fushatave elektorale me ato të raportimit për politikën në periudhat jashtë fushatave, si mënyrë për të favorizuar partinë më të madhe. Në raportim, aktivitetet e PDK-së vazhdimisht janë renditur të parat dhe jo sipas parimit që zbatohet për fushata, edhe pse përmbajtja e kronikave ka qenë nga aktiviteti elektorale. Në këto raste, mënyra e raportimit dhe struktura e kronikave, ndjek skemën hierarkike të lajmeve, ku “çështjet janë kryesisht të

¹² European Union Election Observation Mission, Final Report Kosovo 2014,

<http://eeas.europa.eu/eueom/missions/2014/kosovo/pdf/eueom-kosovo-2014-final-report-en.pdf>

organizuar sipas skemës abstrakte të përbërë nga kategoritë konvencionale”¹³ dhe ku pushteti është faktori kryesor në superstrukturën e skemës së lajmeve.

Me moszbatimin e parimit të rotacionit, por duke i renditur sipas fuqisë politike në zgjedhjet paraprake (deri te partia e tretë, pasi edhe ky parim është shkelur në rastin e AAK-së dhe Vetëvendosjes), RTK-ja i ka krijuar hapësirë më të madhe përfaqësimi PDK-së si parti në pushtet, edhe në aspektin cilësor. Arsyetimi se të gjitha subjektet kanë pasur trajtim të barabartë, del i paqëndrueshëm përderisa në renditjen e kronikave favorizohet partia kryesore në pushtet dhe nuk respektohet renditja sipas fuqisë së votave të subjektet opozitare.

Favorizimi për subjektin në pushtet është fuqizuar edhe me përfaqësimin e liderit brenda strukturës së kronikave, ku ai del si figura kryesore, në cilësi të kryeministrit dhe liderit partiak.¹⁴ Edhe pse me standardet profesionale RTK-ja obligohet të bëjë dallimin e qartë në raportim të këtyre pozitave, gjatë parafushatës, kjo nuk është bërë, pasi premtimet e kryeministrit me ndikim të menjëhershëm në çështje buxhetore shtetërore janë raportuar sipas parimeve për mbulimin e fushatave elektorale zyrtare. RTK-ja nuk i ka trajtuar si tema që kërkonin analizë dhe shtjellim profesional premtimet elektorale jashtë fushatës të kryeministrit për rritje pagash në sektorin publik, fonde të veçanta për trajtimin e fëmijëve nga leukemia etj. Shmangia nga standardet profesionale në favor të krijimit të hapësirës për promovim të lidërshiptit politik, i ka bërë lajmet e RTK-së

¹³Teun A. van Dijk, *The Interdisciplinary study of news as discourse*, në: *A Handbook of Qualitative Methodologies for Mass Communication Research*, Taylor & Francis e-Library 2002, fq. 115

¹⁴ Nga monitorimi i edicioneve qendrore të lajmeve, Lajme 19:30, në muajt prill dhe maj 2014.

platformë promovimi dhe marketingu, në të cilën mesazhi politik është bartur tek audienca pa iu nënshtruar redaktimit dhe shtjellimit të thelluar nga gazetarët. Në këtë mënyrë lajmet e RTK-së largohen edhe nga paanshmëria si standardi kryesor profesional, pasi edhe kur sasia në kohë të tërësishme të transmetimit, apo përmendja e palëve të ndryshme në lajme, është e barabartë, ose në favor të opozitës, nuk ka balancim në përfaqësimin cilësor në informacion.

Konkluzione dhe rekomandime

Radiotelevizioni i Kosovës shndërron lajmet në hapësirë promovimi dhe marketingu politik për liderët e forcave kryesore politike dhe për të arritur këtë shfrytëzon zbrazëtitë në bazën ligjore për mbulimin e zgjedhjeve dhe në standardet profesionale. RTK-ja i shmanget përgjegjësisë mediatike që ka, duke u arsyetuar me faktin se lidershipi politik keqpërdor pozitën shtetërore për të paralajmëruar si ngjarje të propozuara për mbulim mediatik, aktivitete të cilat përdoren për promovimin e projekteve elektorale. Të dy elementet e mësipërme përdoren nga RTK-ja dhe nga subjektet kryesore politike, në funksion të zgjerimit të hapësirës së promovimit të tyre brenda edicionit qendror të lajmeve. Në këtë mënyrë, mediumi publik u mundëson politikanëve, si komunikues të zotë, që të keqpërdorin hapësirën transmetuese, të dedikuar për trajtimin e çështjeve me interes publik. Ajo e privon audiencën nga informacioni i dobishëm dhe në formë dijeje për realitetin politik, pasi që në lajme ofron vetëm qëndrimin e liderëve të cilët promovojnë projekte elektorale, por nuk i trajton në thellësi dhe me qasje analitike premtimet elektorale jashtë fushatës zyrtare elektorale.

Për të shmangur përsëritjen e gjendjeve si ajo e vitit 2014, për RTK-në është e nevojshme që të përfshijë në standardet profesionale rregullat për mbulimin e periudhave të parafushatave. Me politikën e saj editoriale, RTK-ja e ka të domosdoshme që të zbatojë standardet e trajtimit të drejtë dhe të paanshëm të të gjitha palëve, duke i dhënë përparësi informacionit gjithëpërfshirës dhe me cilësitë e shërbimit publik. Për ta realizuar këtë, në lajmet e RTK-së është e nevojshme që ndryshojë qasja editoriale ndaj *pseudo ngjarjeve* dhe *pseudo mjedisit*, ku protagoniste janë forcat kryesore politike.

Bibliografia

Balas R. Glenda, *Recovering a public vision for public television*, Rowman & Littlefield Publishers 2003

Blumler G. Jay, Gurevitch Michael, *The Crisis of Public Communication* Taylor & Francis e-Library

Kuhn Raimond, *Broadcasting and politics in Western Europe*, Frank Cass and Company Limited, London 1985

Hanretty Chris, *Public broadcasting and political interference*, Tayler&Francis LTD, United Kington 2011

Lippman Walter, *Public opinion*, Transaction Publishers, New Brunswick USA 1991

McNair Brian, *Hyrje në komunikimin politik*, UET Press, Tiranë

McChesney W Robert, Pickard Victor, *Will the last reporter please turn out the lights – the colapse of journalism and what can be done to fix it*, The new press, New York 2011

Benson Rodney, Powers Matthew, *Public Media and political independence: Lessons for the Future of Journalism from Around the World*, *New York University Department of Media, Culture and Communication*, 2001

Camaj Lindita, Media Use and Political Trust in an Emerging Democracy: Setting the Institutional Trust Agenda in Kosovo, *International Journal of Communication* 8, 2014

Esser Frank, Editorial structure and work principles in British and German newsrooms, *European Journal of Communication*, 1998

Teun A. van Dijk, The Interdisciplinary study of news as discourse, në: *A Handbook of Qualitative Methodologies for Mass Communication Research*, Taylor & Francis e-Library 2002

Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, Nr. 04 / L - 46, Neni 18, pika 8, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7 / 27 prill 2012

Ligji Nr. 0/L-073, për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare 31/2008 dhe Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i publikuar në Gazetën Zyrtare më 16.11.2010

Statuti i Radiotelevizionit të Kosovës, i miratuar në mbledhjen e bordit, të datës 7 nëntor 2012

Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radiotelevizionit të Kosovës

European Union Election Observation Mission, Final Report Kosovo 2014, http://eeas.europa.eu/eueom/missions/2014/kosovo/pdf/eu-eom-kosovo-2014-final-report_en.pdf.

Public Service Values – Editorial Principles and Guidelines, EBU Operating Eurovision and Euroradio, https://www.ebu.ch/files/live/sites/ebu/files/Publications/EBU-Public_Service_Values.pdf.

Deklaratë e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës Isa Mustafa, më 3 maj 2014, publikuar në faqen e tij zyrtare në Facebook <https://www.facebook.com/isamustafa.rks?fref=ts>

Deklarata nga konferenca për shtyp e LDK-së e datës 26 maj 2014, transmetuar në Lajmet 19:30 në RTK, marrë nga arkivi i lajmeve në kanalin “Youtube” të RTK-së